



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 18 korrik 2014
Nr.ref.:RK678/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI42/14

Parashtrues

PTK-SHA, Prishtinë

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 238/2013, të 7 nëntorit 2013, me kërkesë për aplikimin e Masës së përkohshme

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Shoqëria Aksionare – Post-Telekomi i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: PTK-SHA, Prishtinë), të cilën e përfaqëson z. Lulzim Sokoli, menaxher për çështje legale dhe administratë në PTK.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 238/2013, i 7 nëntorit 2013, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 3 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), sipas nenit 31 (E Drejta për një Proces të Rregullt), lidhur me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), nenit 46 e drejta në pronë, si dhe e drejta në pronë sipas nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Neni 113.7 lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 mars 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 1 prill 2014, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI42/14, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI42/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 22 prill 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 19 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 13 dhjetor 2011, parashtruesi ka marrë vendimin për zvogëlimin e të gjitha shpenzimeve operacionale duke përfshirë edhe shpenzimet për personelin në masën prej 20%. Në sektorët e punës ku është zbatuar vendimi, detyrimisht ka ndikuar në uljen e pagave të punëtorëve të parashtruesit. Ky vendim, sipas parashtruesit, ishte marrë në bazë të kërkesës së pronarit të të gjitha aksioneve të ndërmarrjes - Qeverisë së Kosovës, të 7 dhjetorit 2011.
10. Më 11 maj 2012, M. Sh., i punësuar te parashtruesi PTK-SHA – Prishtinë, i goditur nga vendimi i punëdhënësit, ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Pejë, duke kontestuar vendimin për ndryshimin e gradës së kategorizimit në

punë nga grada 7 në gradën 6 dhe uljen e pagës së tij së bashku me beneficionet që i takonin me pagën si bonuset dhe pagesa e trustit.

11. Më 19 mars 2013, Gjykata Themelore në Pejë ka nxjerrë Aktgjykimin C. nr. 364/12, me të cilin padinë e paditësit M. SH. e ka aprovuar tërësisht si të bazuar.
12. Në arsyetimin e aktgjykimit, në mes të tjerash, Gjykata Themelore e Pejës ka theksuar: *"Gjykata duke vendosur lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kontestuar me të cilin vendim paditësit i është ulur grada e të ardhurave personale nga grada 7 në gradën 6 gjykata duke u mbështetur në dispozitat e neni 10.1,2, pika 2. I, 10.3, 10.5, II, 55, 56 të Ligjit të Punës me Nr. 03/L-2012, e lidhur me nenin 5 të kontratës së punës, e lidhur me datën 20.10.2011, gjykata erdhi në përfundim se vendimi i kontestuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe në kundërshtim me neni 5 të kontratës së punës"*.
13. Gjykata Themelore më tej ka potencuar: *"Gjykata konstaton se marrëdhënia e punës është marrëdhënie juridike-kontraktuese ku palët me rastin e lidhjes së një kontrate të tilla duhet të respektojnë kushtet e kontratës si tërësi për çka në rastin konkret gjykata konstaton se kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës është lidhur duke u respektuar të gjitha kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës siç janë aftësia punëse e palëve kontraktuese, pajtimi i vullnetit të palëve, lënda-objekti i kontratës dhe baza e kontratës"* dhe në këtë drejtim kjo gjykatë gjithashtu ka gjetur se *"konstaton se kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës ka mundur të ndryshohet vetëm me vullnetin e shprehur të të dyja palëve dhe se e paditura nuk ka mundur t'i ndryshoj kushtet e kontratës vetëm me shprehjen e njëanshme të vullnetit të saj"*.
14. Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës në afatin ligjor ka bërë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
15. Më 12 korrik 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës nxori Aktgjykimin Ac. nr. 1447/13, me të cilin pranohet ankesa e parashtruesit, ndryshohet Aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Pejë, C. nr. 364/12, i 19 marsit 2013, në atë mënyrë që ankesa e paditësit M. SH. refuzohet si e pabazuar.
16. Duke kontestuar arsyetimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Gjykata e Apelit, në mes të tjerash ka theksuar: *"Kjo gjykatë ka vlerësuar përfundimin e këtillë të gjykatës se shkallës së parë dhe ka gjetur se një vendim dhe qëndrim i tilla juridik nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm nga se, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, mbi gjendjen e tilla faktike gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur ajo, gjykata e shkollës së parë, ka gjetur se kërkesëpadia e goditësit është e bazuar."*
17. Gjykata e Apelit, më tej, duke arsyetuar aktgjykimin e saj, ka potencuar:
"Kjo, veç tjerash edhe për faktin se e paditura ka vepruar në përputhje të plotë me vendimin e aksionarit – Qeverisë së Republikës së Kosovës,

përkatësisht të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, e cila kishte rekomanduar reduktimin e shpenzimeve për personelin e se goditurës (PTK-se), duke u bazuar në politikat e brendshme, ne pajtim me to si dhe ne pajtim me planin e biznesit për vitin 2012, si kundër edhe vendimit të bordit të drejtorëve të datës 13. 12.2011, e me qellim të uljes së shpenzimeve të stafit në maksimum 20% të të hyrave të përgjithshme, e krejt kjo u muar vesh duke iu referuar vendimit të aksionarit - Ministrisë së Zhvillimit Ekonomike të datës 06.12.2011 etj”.

18. Më 17 nëntor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas revizionit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nga M. SH. nxori Aktgjykimin Rev. nr. 238/2013, me të cilin ia pranoi revizionin paditësit dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1447/13, të 12 korrikut 2013, duke vendosur që në fuqi të mbetet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C. nr. 364/12, i 19 marsit 2013.
19. Në arsyetim të aktgjykimit, “Gjykata Supreme i ka vlerësuar si të bazuara thëniet e revizionit se aktgjykimi i goditur është në kundërshtim me nenin 55 par. 1 të Ligjit të punës (Gazeta zyrtare 03-L-212 -te RK) ku është përcaktuar se i punësuari ka të drejtë në pagë e cila caktohet me kontratë të punës e ne pajtim me këtë Ligj, kontratën, kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditësit sipas kontratës së punës ka qene në gradën 7-të dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe ligjit”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë sipas nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenit 46 (E drejta e pronës dhe të drejtat e garantuara me KEDNJ), nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) dhe nenit 1 të Protokollit shtesë (Mbrojtja e pronës).
21. Parashtruesi i mbështet pretendimet e tij për shkeljet e dispozitave kushtetuese dhe të KEDNJ-së në argumentet vijuese:

Shkelja e pretenduar e nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ

E drejta për një proces të rregullt dhe të paanshëm, sipas parashtruesit të kërkesës, me aktgjykimin e kontestuar i është shkelur, sepse Gjykata Supreme ka dhënë një arsyetim tërësisht kontradiktor me arsyetimin e dhënë në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, dhe se kjo çmuarje tërësisht e kundërt e gjendjes faktike dhe e aplikimit të së drejtës materiale nga dy gjykata kanë rezultuar me shkeljen e pretenduar të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, sepse sipas parashtruesit, është cenuar njëra nga garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së, e drejta në vendim të arsyetuar.

Parashtruesi më tej ka kërkuar nga Gjykata që prej – Qeverisë së Kosovës, si pronare e Aksioneve të PTK-së, të kërkojë sqarim zyrtar nëse kërkesa e saj për ulje të shpenzimeve operative për 20% i referohet edhe uljes së shpenzimeve për personelin.

Shkelja e pretenduar e nenit 46 të Kushtetutës lidhur me nenin 1 të protokollit shtesë të KEDNJ

E drejta e pronës, e garantuar me Kushtetutë dhe me Protokollin shtesë të KEDNJ-së, sipas pohimeve të parashtruesit, është shkelur, sepse *"arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës nuk korrespondon me gjendjen reale të fakteve"*. Aktgjykimi i kontestuar në mënyrë të paligjshme dhe arbitrare parashtruesen e ka privuar nga prona e saj.

22. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata aplikimin e masës së përkohshme, me të cilën Gjykata Supreme e Kosovës do të obligohej të mos shqyrtojë lëndët eventuale me objekt të njëjtë shqyrtimi që mund të vijnë në të ardhmen, derisa të merret vendimi lidhur me këtë kërkesë nga Gjykata Kushtetuese, sepse përndryshe do të cenohej rëndë interesi publik.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës.

24. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

25. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

*"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) Kërkesa është qartas e bazuar"*

26. Në vlerësimin e pretendimeve të ngritura nga parashtruesi, Gjykata vëren që ai e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 238/2013, të 17 nëntorit 2013, me të cilin Gjykata vendosi lidhur me revizionin e parashtruar nga M. SH., një punëtor i parashtruesit.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe të KEDNJ-së lidhur me rastin

27. Gjykata me këtë rast përkujton se Kushtetuta e Kosovës dhe KEDNJ-ja, në dispozitat e kontestuara nga parashtruesi, përcaktojnë:

Neni 31 i Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

[...]

Neni 6 .1 i KEDNJ

E drejta për një proces të rregullt

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

[...]

Neni 1 i Protokollit shtesë i KEDNJ-së, Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

28. Për të vendosur në mënyrë meritore lidhur me kërkesën, Gjykata gjithashtu merr parasysh dispozitat e Ligjit për gjykatat, 2010/03-L-199, të dekretuar më 9 gusht 2010, ku është përcaktuar se:

Neni 21, Gjykata Supreme

1. Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka jurisdikcion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

[...]

dhe

Neni 22, Kompetencat e Gjykatës Supreme

1.3. përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës.

[...]

29. Duke vlerësuar kushtetutshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në prizmën e pretendimeve për shkelje kushtetuese dhe fakteve që kanë mbështetur këto pretendime, duke i krahasuar këto fakte me përmbajtjen e dispozitave si më sipër, Gjykata konstaton se nuk gjeti argumente që të kenë ndodhur shkelje të dispozitave kushtetuese dhe të KEDNJ-së, aq më tepër kur këto pretendime që janë mbështetur në “konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike” në argumente të zbatimit të ligjshmërisë dhe jo kushtetutshmërisë si dhe në pakënaqësinë evidente lidhur me rezultatin final të procesit gjyqësor.
30. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se përshtetimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, dhe konstatimi se ato janë shkelur, pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa përcaktuar rrethanat, pa specifikuar veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me gjykimin e drejtë e të paanshëm, nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së lidhur me një proces të rregullt dhe të paanshëm.
31. Gjykata më tej konstaton se ajo nuk është gjykatë e faktit, nuk gjykon si gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk është thjesht një instancë gjyqësore më tepër. Gjykata në parim nuk gjykon faktin nëse gjykatat e rregullta drejt dhe në mënyrë të plotë e kanë konstatuar gjendjen faktike. Për Gjykatën, janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të të drejtave kushtetuese dhe jo çështjet qartazi ligjore që kryesisht kanë qenë fakte të paraqitura nga parashtruesi (shih, *mutatis mutandis*, i. a., *Akdivar kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).
32. Lidhur me si më sipër, Gjykata thekson se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të rregullt të vendosin për renditjen e rëndësisë së provave dhe të çmojnë se cila provë në vështrim të zbatimit të drejtë të ligjit në fuqi ka përparësi, sikur që në rastin konkret pa dyshim se i ka takuar Gjykatës Supreme

të vendosë sa është i drejtë qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë apo i asaj të Apelit dhe këtë ta sanksionojë me vendim të saj përfundimtar gjyqësor.

33. Kjo aq më tepër kur merret parasysh se Kushtetuta e Kosovës, në nenin 103.2, ka përcaktuar se Gjykata Supreme është autoriteti më i lartë gjyqësor, ndërsa Ligji për gjykatat, Gjykatës Supreme i ka dhënë kompetencë “*zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës*” dhe rrjedhimisht edhe unifikimin e praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta.
34. Në këtë drejtim, Gjykata nuk gjeti se arsyetimet e ndryshme të gjykatave të dy instancave gjyqësore kanë rezultuar me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse aktgjykimi përfundimtar i Gjykatës Supreme ka përmbyllur vlerësimin edhe të gjendjes faktike, edhe të aplikimit të ligjshmërisë, dhe në asnjë mënyrë gjykata nuk ka mundur të gjejë që të jetë shkelur *e drejta për një vendim të arsyetuar* si një nga garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së e të drejtës për gjykim të rregullt e të paanshëm.
35. Për më tepër, Gjykata rikujton se GJEDNJ-ja, gjatë praktikës së vet gjyqësore, ka vlerësuar se detyrimi që ka një gjykatë vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Detyrimi për të arsyetuar vendimin varet nga natyra e vendimit në fjalë. Kur Gjykata Supreme nuk pranon një ankesë për shkak se nuk është parashtruar baza ligjore e çështjes, kërkesat e nenit 6 të Konventës mund të plotësohen me një arsyetim shumë të kufizuar (shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet *Marini kundër Shqipërisë*, 18 dhjetor 2007 §105 dhe *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, 7 dhjetor 2010).
36. Gjykata, më tej, në përgjigje të pretendimit për shkelje të së drejtës së pronës, konstaton se nuk mund të gjejë fakte se parashtruesi është privuar nga prona në mënyrë arbitrare, përkundrazi çështja kontestuese në mes të palëve është zgjidhur nga një “*gjykatë e themeluar me ligj*” dhe në një proces gjyqësor të paraparë me ligj, andaj një vendim gjyqësor i nxjerrë në kushte të tilla nuk mund të cilësohet nga kjo gjykatë si arbitrar, aq sa të jetë tregues i shkeljes së pretenduar.
37. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese apo të drejte të garantuar me KEDNJ, andaj nuk mund të konstatohet se ka cenim të të drejtave të njeriut me vendimin e kontestuar dhe në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika b, gjeti se kërkesa duhet të deklarohej e papranueshme si qartazi e pabazuar.

Kërkesa për Masë të përkohshme

38. Duke marrë parasysh faktin se kërkesa në tërësi shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar, Gjykata gjeti se kjo kërkesë duhet refuzuar, sepse aplikimi i kësaj mase në formën çfarë është kërkuar nga parashtruesi, do të mbetej jolëndor dhe tërësisht i pabazë.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 19 maj 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Arta Rama-Hajrizi



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani